



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 06, Datë 06.01.2025

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“VOLTON” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “e”, 5, pika 1, gërma “e”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.01.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2584/1 prot., datë 27.12.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “VOLTON” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “VOLTON” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2584 prot., datë 19.12.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gërmat “a” “b” dhe “c”; si dhe për pikën 1.2, gërmat “a”, “b” dhe “d”.
- Nga ky aplikim nevojitet të plotësohet dhe informacioni/dokumentacioni në vijim:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

- **gërma “c”:** Shoqëria duhet të depozitojë dokumentin mbi strukturën organizative të saj me nënshkrimin dhe/ose vulën përkatëse.

- *Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal*
- **gërma “a”**: Shoqëria duhet të depozitojë vërtetimin që nuk ka detyrime të pashlyera ndaj organit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.
- **gërma “b”**: Shoqëria duhet të dokumentojë aftësinë financiare për të garantuar ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike për të paktën 1 muaj, në përputhje me parashikimet e planit të biznesit. Edhe pse është depozituar një kontratë huaje e datës 22.10.2024 midis “Albanian Development Company ADC” sh.p.k. dhe “VOLTON” sh.p.k. kjo shumë është përdorur për dokumentimin e mbështetjes financiare në kuadër të një licence të mëparshme për furnizim me energji elektrike dhe nuk mbulon tërësisht nevojën financiare për tregtimin e parashikuar.
- **gërma “c”**: Shoqëria duhet të depozitojë planin e biznesit me nënshkrimin dhe/ose vulën përkatëse dhe ta plotësojë atë me sasinë që parashikon të tregtojë dhe për 4 vitet e tjera të licencës.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “VOLTON” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “VOLTON” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI